



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr \_\_\_\_\_prot

Tiranë më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2024

**VENDIM**

**Nr. 727, datë 05.12.2024**

**PËR**  
**CAKTIMIN E NJË GJYQTARI NË POZICIONIN E KËSHILLTARIT PËR**  
**ETIKËN NË KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronja “a” dhe “ë” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 61, pika 1, 63 dhe 83, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si edhe në nenin 14, pika 2 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale,

**VENDOSI:**

1. Caktimin e znj. {...} , gjyqtare në Gjykatën e Lartë, në pozicionin e Këshilltarit për Etikën, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, pa u shkëputur nga ushtrimi i detyrës së gjyqtarit.
2. Këshilltari për Etikën shërben për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë dhe përfiton një trajtim financiar 5% shtesë page, mbi pagën bruto fillestare të tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**